

UDC 343.137.5

Dr. Sc. Hashim Çollaku, PhD³¹⁷

**EFIKASITETI I PROCEDURËS PENALE PËR TË MITUR DHE
RUAJTJE E DINJITETIT TË TË MITURIT**

**ЭФИКАСНОСТА НА КАЗНЕНАТА ПОСТАПКА ЗА
МАЛОЛЕТНИЦИ И ЗАШТИТА НА ДОСТОИНСТВОТО НА
МАЛОЛЕТНИЦИТЕ**

**EFFICIENCY IN THE PENAL PROCEDURE FOR MINORS AND
THE PROTECTION OF THE MINOR'S DIGNITY.**

Abstract

Criminal-procedure law is characterized by four stages of development: the investigative phase, the phase of the indictment and the defendant's statement, the trial phase and phase with respect to remedies. Through these stages passes also the procedure for the juvenile criminal offenses.

Minors participate considerable in crime, which means that society's concern for further work are juvenile perpetrators of criminal acts. This obliges holders of responsibilities, prosecutors, judges, police and other bodies that work to implement the legal provisions that refer juvenile offenders to criminal offenses. As the most sensitive categories of criminal procedure requires special attention

It works like acts and international agreements and domestic legal framework guaranteeing the rights and fundamental freedoms,

³¹⁷ Gjyqtar - Gjykata e Apelit Prishtinë
Ligjërues në Universitetin e Prizrenit

which are guaranteed and preserved the dignity of minors.

Code of Juvenile Justice was taken in the spirit of the Constitution of the Republic of Kosovo as well as acts of international agreements. Diversity measures oblige prosecutors and judges to new challenges in working with juvenile offenders offenses

Maintain dignity of juvenile offenders offenses must constantly have positive support legal provisions, involving the guarding of human character, educational, economic, etc..

Keywords: carrier responsibilities in juvenile criminal proceedings, concern for society, crime prevention, criminal procedure efficiency, diversity measures, procedures for the juvenile criminal offenses, the preservation of the dignity of minors.

HYRJA

Në temën të cilën e kam punuar, kam paraqitur disa karakteristika kryesore të procedurës penale për të mitur, sipas Kodi i Drejtësisë për të Mitur në Kosovë (në vazhdim KDM), duke pasur parasysh që këto ndikojnë në efikasitetin procedurës penale për të mitur dhe ruajtjen e dinjitetit të tyre.

Kosova me të përfunduar të luftës më datë 10 qershor 1999, ka dal me institucione të rrënuara dhe infrastrukturë të shkatërruar, është ndie më se e domosdoshme që të fillohet me konstituimin e organeve vetëqeverisëse, me qëllim që të organizohet jeta e qytetarëve.

Fillimisht u punua në drejtim të funksionalizimit të rolit të administratës së përkohshme ndërkombëtare, sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 01/99, 25 qershor 1999, me respektim të standardeve të pranuar ndërkombëtare si dhe me fuqizimin e ligjeve në Kosovë. Por, në nenin 3 të kësaj Rregullore, u shkelën në mënyrë drastike të drejtat e qytetarëve të Kosovës, sepse thuhej: *“ligjet e Kosovës të cilat kanë qenë në fuqi në territorin e saj para datës 24 mars 1999 do të vazhdojnë të zbatohen në Kosovë nëse nuk bijnë në kundërshtim me standardet e përmendura nga neni 2”*. U shkaktuan pakënaqësi të mëdha, sepse në Kosovë, prej vitit 1989 kur janë rrënuar pothuajse të

gjitha institucionet e Kosovës, janë nxjerrë ligjet diskriminuese gjer në përfundimin e luftës, u bë përmirësimi i Rregullores së përmendur.

Rregullorja e UNMIK-ut, nr. 24/99 12 dhjetor 1999, përmirësojë rregulloren ekzistuese, me nenin 1, ndër të tjera theksohet në pikën b. *“legjislacionin në fuqi që do të zbatohet në Kosovë, është për ligjet e nxjerra gjer më 22 mars 1989”*, me sqarimet e tjera gjer në nenin 2.

KDM përpos çështjeve të cilat i trajton dhe janë trajtuar edhe më parë, trajton masat e diversitetit, edukative burgimin për të miture etj. Ngritja e nivelit profesional dhe aftësimi i mëtejme i prokurorëve, gjykatësve, si dhe përfaqësuesve të institucioneve të tjera duhet të vazhdon me ritëm më të shtuar.

Në temë në mënyrë kronologjike do të paraqes zhvillimin dhe zbatimin e procedurës përgatitore për të mitur në Kosovë e cila ndërlihet me efikasitetin dhe ruajtjen e dinjitetit të të miturit,

1. Historiku i Procedurës Penale për të Mitur në Kosovë

Në Kosovës, në aplikim deri nxjerrjen e KDM³¹⁸ në fuqi ishte LPMK³¹⁹, si dhe të gjitha dispozitat e ligjeve të procedurës penale të cilat iu janë referuar punës së subjekteve në procedurë për të mitur, sipas Rregullores së UNMIK-ut, nr. 01/99³²⁰ dhe 24/99³²¹.

Duke pasur parasysh këtë situatë, u punua për nxjerrjen e ligjeve të reja që Kosova të shkëputet përfundimisht nga aplikimi i ligjeve të shtetit inekzistent. plotësohet U nxor Ligji Penal i për të Mitur i Kosovës (në vazhdim LPMK), sipas Rregullores së UNMIK-ut, nr. 8/2004, 20 prill 2004. U vlerësua e arritur e madhe, sepse me Kodin Penal të Kosovës, Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, Ligjin mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, përfundimisht u shkëput kontinuiteti legjislativ i shtetit inekzistent – ish-Jugosllavi dhe aplikimi i ligjeve të saj në Kosovë. Me aplikimin e LPMK, u plotësua boshllëku

³¹⁸ Kodi i Drejtësisë për të Mitur nr.03/L-193, 08. korrik, 2010.

³¹⁹ Rregullorja e UNMIK-ut, nr. 2004/8 e datës 20 prill 2004.

³²⁰ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 1/99 e datës 25 qershor 1999, Për Autorizimet e Administratës së Përkohshme në Kosovë.

³²¹ Rregullorja e UNMIK-ut nr 24/99,12 dhjetor 1999, Për Ligjin në Fuqi në Kosovë.

që u krijua nga fusha e punës me kryerësit e mitur të veprave penale. Teoricienëve dhe praktikientëve u interesonte aplikimi gjatë punës, ashtu që pas ardhjes në përfundim se janë paraqitur vështirësi u bënë përpjekje për nxjerrjen dhe finalizimin e KDM. Me KDM jenë bërë përpjekje sa i përket konkretizimit të dispozitave ligjore me qëllim lehtësimi për punë.

Procedura penale me kryerësit e mitur, si kategoria më sensitive e shoqërisë kërkon harmonizim dhe përshtatje të dispozitave ligjore në frymën e Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në vazhdim KRK)³²² si dhe akteve dhe marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare. Dispozitat Ligjore të KDM, instrumentet dhe aktet ndërkombëtare, japin përkufizimin ligjor për të mitur, që nënkupton personin, i cili në kohën e kryerjes së veprës penale, ka qenë i moshës 14 (katërbëdhjetë) deri në moshën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeçare.

Të miturit si kryerës të veprave penale, kanë pjesëmarrje në kriminalitetin e përgjithshëm shtetëror me 8%, atëherë parashtrohet pyetja se korniza ligjore ekzistuese, a mjafton si e tillë. Ndërmarrja e hapave konkret, për të arritur standarde më të mira për punën me kryerësit e mitur të veprave penale, vërehet në punën e gjykatave, prokurorive si dhe mekanizmave të tjerë përcjellës.

Kategorisë së personave të mitur, iu është kushtuar kujdes i duhur, gjatë zhvillimit të procedurës së posaçme. Kjo ka qenë e rregulluar edhe sipas ligjit i cili ishte në fuqi në shtetin inekzistent ish-Jugosllavi. Dispozitat ligjore që iu janë referuar punës me të mitur, kanë qenë të paraparë në Ligjin e Procedurës Penale të RSFJ-së, (LPP të RSFJ)³²³, i cili ka shfuqizuar LPP-në, që ka qenë në aplikim sipas gazetave zyrtare të RSFJ-së, nr 50/67, 54/70 dhe 6/73. Në Kapitullin 27 janë paraparë dispozitat ligjore të cilat u referohen procedurës penale e cila zhvillohet për kryerësit e mitur të veprave penale³²⁴, si dhe aplikimi përshtatshëm i dispozitave të tjera ligjore gjatë punës.

³²² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 15 prill 2008, në fuqi nga 15 qershor 2008.

³²³ Ligji i Procedurës Penale, Gazeta zyrtare e RSFJ nr. 4/77, 01 korrik 1977.

³²⁴ Po aty, neni 452-492.

2. Zhvillimi i Procedurës Penale për të Mitur në Kosovë

Pas datës 10 qershor 1999, me të përfunduar të luftës, Kosova doli pa institucione, andaj, me qëllim të funksionimit të rendit të përgjithshëm shoqëror, u pa më se e nevojshme që të fillohet me konstituimin e institucioneve të përkohshme vetëqeverisëse. Administrata e Përkohshme në Kosovë, filloi që të instalohet në funksionim të gjithë pushtetit, duke filluar nga ai legjislativ dhe ekzekutiv, si dhe administrimin e organeve të drejtësisë, duke u ushtruar nga ana e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (PSSP)³²⁵. Me të njëjtën Rregullore parashihet që cilat ligje do të jenë në fuqi, si dhe hyrja në fuqi e Rregulloreve të cilat do të nxirren nga UNMIK-ut.

Në plotësim të Rregullore 1/99 pasi që u vërejt se u krijua zbrazëti dhe u krijua paqartësi për aplikimin e ligjeve në fuqi, u pa e nevojshme që të nxirret Rregullorja 24/99 në të cilën decidivisht u theksua në nenin 1 par 1. 1 (b) ; ***“që në Kosovë do të jenë në fuqi të gjitha ligjet të cilat kanë qenë gjer më datën 22 mars 1989 “***.

Gjithashtu u parapanë edhe instrumentet dhe aktet e tjera ndërkombëtare që duhet të jenë në fuqi, dhe të cilat u referohen garantimit të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, me theks të posaçëm duke ruajtur personalitetin dhe integritetin edhe të miturve. Me theks të posaçëm Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat e fëmijëve e 20 dhjetor 1989³²⁶.

Fillimi i punës së gjykatave dhe prokurorive në territorin e Kosovës, filloi me Rregulloren e posaçme për themelimin e Gjykatës Ad Hoc dhe Zyrës Ad Hoc të prokurorit publik³²⁷. Rregulloret të cilat nxirren nga ana e Përfaqësuesit Special i Kombeve të Bashkuara, vlejné për tërë territorin e Kosovës dhe rregullojnë fusha të caktuara. Me rregulloret e nxjerra, përkundër asaj që në ato momente rregullohej materia konkrete, me paraqitjen e ndryshimeve të përgjithshme,

³²⁵ Rregullorja e UNMIK-ut, 01/99 , 25 qershor 1999, neni 1.

³²⁶ Rregullorja e UNMIK-ut, 24/99, 12 dhjetor 1999, neni 1 par 1 3 (h).

³²⁷ Rregullorja e UNMIK-ut, 05/99 ,04 shtator 1999.

ndiqet hapi për nxjerrjen e ligjeve të reja dhe të përshtatshme me rrethanat ekzistuese.

Në Kosovë nuk rregullohej procedura penale për të mitur me Ligj Penal për të Mitur, por rregullohej me dispozitat nga LPP, që krijoi vakum deri në nxjerrjen e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK)³²⁸, Kodit Penal të Kosovës (KPK)³²⁹. Nuk parashihej rregullimi me dispozita përkatëse, andaj, qëllim që mos të krijohet vakuum ligjor, me sugjerimin e ekspertëve vendor dhe ndërkombëtar, u përshpejtua procedura për nxjerrjen e LPMK, për tu rregulluar procedura me kryesit e mitur të veprave penale. Me nxjerrjen dhe hyrjen në fuqi të KDM, shfuqizohet LPMK dhe del nga aplikimi.

3. Efikasiteti ne procedurën penale për te mitur

Nisur nga Deklarata Universale e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (DUKBNJ)³³⁰ në nenin 7 thuhet: ***të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtën pa asnjë diskriminim të mbrohen njësoj nga ligji. Të kanë të drejtën për t'u mbrojtur njësoj kundër çdo diskriminimi që cenon këtë Deklaratë, si dhe kundër çdo nxitje për një diskriminim të tillë***, Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ)³³¹ me nenin 2,3,4,5..., me tekstin që u referohet mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, Paktin Fakultativ për të Drejtat Civile dhe Politike³³² nenin 14 që flitet për barazinë e palëve para ligjit, Konventën mbi të Drejtat e fëmijës³³³ përkatësisht nenin 1: ***Për qëllimet e kësaj konvente, fëmijë do të thotë çdo qenie njerëzore nën moshën tetëmbëdhjetë vjeçare, përveç nëse sipas ligjit të aplikueshëm për fëmijën, pjekuria arrihet më***

³²⁸ Rregullorja e UNMIK-ut, nr. 26/2000, 06 korrik 2003.

³²⁹ Rregullorja e UNMIK-ut, nr. 25/2003, 06 korrik 2003.

³³⁰ Deklarata Universale e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut e dt. 10 dhjetor 1948.

³³¹ Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, 1950.

³³² Paktin Fakultativ për të Drejtat Civile dhe Politike 1966.

³³³ Konventën mbi të Drejtat e fëmijës , 20.11.1989.

herët” si dhe në nenet tjera në vazhdimësi, Deklarata mbi të Drejtat e fëmijës³³⁴ etj. Krahas akteve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare në Kosovë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut garantohen Kushtetuta e Republikës së Kosovës³³⁵, kapitulli dy neni 23: “*Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut*” së bashku me dispozitat që garantojnë të drejtën për jetë, integritet personal, e drejta e ndalimit të torturës e shume të tjera. Me kë kornizë ligjore ndërkombëtare dhe vendore nuk përfundohet nga se vlejné edhe dispozitat nga LPMK, KPK, KPPK, duke i kushtuar kujdes efikasitetit në procedurën penale për të mitur. Respektimi e instrumenteve dhe akteve ndërkombëtare, ligjeve vendore rrit efikasitetin por edhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut me rastin konkret dinjitetin e të miturit.

Kryerësit e mitur të veprave penale, si kategoria me e posaçme për pune kërkojnë trajtim më të privilegjuar gjatë punës. Paraqitet nevoja për infrastrukturë ligjore më adekuate dhe ofrimi i kushteve më të mira për punë bazuar në kornizën ligjore vendore dhe atë ndërkombëtare. Në LPMK jepet përkufizimi ligjor sa i përket të miturve, ashtu që me të mitur kuptohet personi i cili në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i moshës 14 (katërmbëdhjetë) vjeçare, deri në moshën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeçare. Gjithashtu përkufizimi ligjor i kategorisë së personave të mitur jepet edhe në konventë ndërkombëtare.

Të miturit si kryerës të veprave penale kanë pjesëmarrje bukur të theksuar në kriminalitetin e përgjithshëm shtetëror, rreth 11-12%, që dëshmohet nga statistikat e punuara në nivel shtetëror, e cila është mjaft shqetësuese dhe mobilizon të gjitha strukturat e shtetit që të miturve tu kushtohet kujdes më i madh. Veçanërisht organet e jurisprudencës duhet të punojné me përkushtim më të madh që integrimi i të miturve të jetë më dinjitoz.

³³⁴ Deklarata mbi të Drejtat e fëmijës, 20.11.1959

³³⁵ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, dt. 9 prill 2008, në fuqi prej dt. 15 qershor 2008.

Si e ardhmja e shoqërisë dhe bartës të proceseve të përgjithshme shoqërore të miturit kërkojnë përkujdesje më të mirë të shtetit me qëllim të vitalizimit dhe integritit në proceset shtetërore. Për tu arritur kjo duhet një shkollim dhe edukim i nivelit më të lartë, integrim i përgjithshëm si dhe punë sistematike me të miturit. Duhet bërë investim me gjithëpërfshirës duke filluar nga kapacitetet humane, objektet hapësinore dhe infrastrukturën ligjore. Parashtrohet pyetja a janë të përmbushura këto tri kushte? Shikuar nga perspektiva e funksionimit aktual në një masë janë prezente por duhet investim më i madh për ngritjen e këtyre kapaciteteve. Me plotësimin e këtyre kushteve drejtpërdrejt ndikohet që pjesëmarrja e të miturve në kriminalitetin e përgjithshëm të jetë më e ulët. Kjo ndërlidhet me efikasitetin e të gjitha subjekteve dhe palëve që drejtpërdrejtë ngrisin efikasitetin në procedurë si dhe garantojnë dinjitetin e të miturit me respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me kornizën ligjore vendore dhe ndërkombëtare.

Për të pasur efikasitet më të mirë, prokuroritë dhe gjykatat duhet pasur numër të mjaftueshëm të prokurorëve dhe gjykatësve, që duhet të jetë në rritje e sipër deri në plotësimin e numrit sa më adekuat. Gjendja materiale jo e kënaqshme e gjyqtarëve dhe prokurorëve, trajnimet joadekuate me të mitur, mosformimi i kolegjeve adekuate për punë me kryesit e mitur me vepra penale ndikojnë në efikasitet në procedurën penale për të mitur.

4. Mbrojtja e dinjitetit e të miturit

Fillimi me punë i gjykatave dhe prokurorive në territorin e Kosovës, vitalizoi jetën në jurisprudencë dhe filluan përpjekjet për një kontribut për parandalimin e shtrirjes së kriminalitetit. Me Rregulloret e nxjerra, puna e gjykatave dhe prokurorive ishte e karakterit *ad hoc*. Ligji i aplikueshëm sipas Rregulloreve të nxjerra nga PSSP, vlejnë për tërë territorin e Kosovës së bashku me instrumentet dhe aktet e tjera ndërkombëtare.

Kosova si pjesë e shtetit tani inekzistent nuk kishte ligj për punën me kryesit e mitur të veprave penale, por ishte pjesë e infrastrukturës ligjore e cila zbatohet si dhe filloi së zbatuari sipas Rregullores së UNMIK-ut 01/1999 dhe me plotësimin e Rregullores 24/1999 deri në nxjerrjen e ligjeve përkatëse të Kosovës. Me nxjerrjen e KPPK, KPK, me qëllim që mos të krijohet vakum ligjor, me sugjerimin e ekspertëve vendor dhe ndërkombëtarë, u përshpejtua procedura për nxjerrjen e LPMK, për të mbuluar punën me kryesit e mitur të veprave penale.

Nxjerrja e LPMK, shënon një të arritur të rëndësishme për punën e organeve të jurisprudencës, sepse punohet me një materie më të kodifikuar, që lehtëson punën e mëtutjeshme. Subjekteve dhe palëve në procedurë u krijohet mundësia që gjatë punës të kenë mundësi që të imponojnë ritëm dhe efikasitet më të mirë. Policia, gjykatësit, prokuroret, pasi që pajisen me infrastrukturë ligjore më të avancuar me siguri do të kenë mundësi që gjatë punës mos të shkelin të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, në rastin konkret të mbrojnë dinjitetin e të miturit. Gjatë dëgjimit të të miturit duhen të respektohen të drejtat e garantuara, në të kundërtën, çdo shkelje paraqet parregullsi për funksionimin e organeve.

Masat e diversitetit, si risi në LPMK, paraqesin pjesën përbërëse të punës me kryesit e mitur të veprave penale, të cilat aplikohen para fillimit të punës në procedurë të rregullt përgatitore me të mitur. Këto masa shqiptohen para sanksioneve penale që mund të shqiptohen të miturve, si masa edukative ose dënime të tjera. Masat e diversitetit u shqiptohen kryesve të mitur të veprave penale me qëllim të parandalimit të fillimit të procedurës përgatitore për të mitur, ekskluzivisht në rastet kur kryesit e mitur kanë kryer veprën penale për të cilën parashihet dënimi me gjobë ose dënimi me burg deri në tri vite.

Kalimi i procedurës për të mitur me të pranuar të kallëzimit penal nënkupton fazën e fillimit të procedurës përgatitore për të mitur, pas përfundimit fazën e vendosjes për paraqitjen e propozimit adekuat për shqyrtim gjyqësor, fazën e pjesëmarrjes së subjekteve

dhe palëve në shqyrtim gjyqësor dhe fazën e punës përkitazi me mjetet juridike.

5. Kodi i Drejtësisë për të Mitur

Nxjerrja e KDM, shënon një epokë të rëndësishme në punën e organeve të jurisprudencës siç janë prokurorit dhe gjykatat, duke u bërë me kod më të avancuar. Normalisht që pjesë e punës e KDM-së, si dhe bartësve të funksioneve të jurisprudencës janë edhe dispozitat ligjore të përgjithshme të KPPK-së, instrumentet dhe aktet e tjera ndërkombëtare, të cilat duhet aplikohen gjatë kryerjes së punës.

KDM, që është në fuqi prej 08 korrik 2010, përmban gjashtë pjesë të ndara në 22 (njëzet e dy) krerë.

a) Pjesa e parë

Parimet udhëzuese dhe dispozitat hyrëse

- kreu i parë– në të cilën janë të parapara, parimet udhëzuese dhe dispozitat hyrëse, me pjesët përshkruese dhe përkufizimeve ligjor të termave fëmijë, i mitur, i mitur madhor i ri, termi i ri, e tjerë³³⁶, parimet udhëzuese si dhe fushën e zbatimit.

b) Pjesa e dytë

Masat dhe dënimet e zbatueshme

- kreu i dytë, – në të cilën janë të parapara, masat dhe dënimet e zbatueshme ndaj të miturve me shpjegimet konkrete për ndjekjen e procedurës penale për të mitur³³⁷,

- kreu i tretë – ndërmjetësimi si pjesë e procedurës jashtëgjyqësore e cila zhvillohet nga personi i tretë i cili është i caktuar nga institucionet dhe i specializuar për ndërmarrjen e veprimit të kërkuar³³⁸,

- kreun e katërt – janë paraparë masat e diversitetit, duke pasur për qëllim paraqitjen e kushteve dhe llojet e masave të diversitetit, si

³³⁶ Neni 2 KDM.

³³⁷ Neni 7 KDM.

³³⁸ Neni 14 KDM.

institute të reja dhe të rëndësishme për efikasitet në proceduralen përgatitore për të mitur³³⁹,

- kreu i pestë – masat edukative , qëllimi, kushtet llojet e tyre dhe mënyra e shqiptimit³⁴⁰,

- kreu i gjashtë e gjashtë – gjoba dhe urdhri për punë në dobi të përgjithshme³⁴¹,

- kreun e shtatë – burgimin për të mitur, qëllimin e shqiptimit, kohëzgjatjen etj duke paraparë edhe procedurën përkatëse³⁴²,

- kreu i tetë - masat e trajtimit të detyrueshëm dhe dënimet plotësuese³⁴³,

c) Pjesa e tretë

Procedura

- kreu i nëntë – zhvillimi i procedurës gjyqësore për kryerësit e mitur të veprave penale, si dhe pjesëmarrjen e institucioneve përkatëse. Institucione përkatëse janë, prokuroria me strukturë organizative, gjykata me strukturë organizative, shërbimi sprovues, qendra për punë sociale, fillimi i procedurës përgatitore, bashkimi i procedurës përgatitore me atë të zakonit, etj.³⁴⁴,

- kreu i dhjetë – përbërja e trupit gjykues për të mitur sipas dispozitave ligjore, si dhe procedurat e veprimit në kuadër të kompetencave përkatëse³⁴⁵,

- kreu i njëmbëdhjetë – procedura përgatitore, duke u përshkruar roli i prokurorit publik në fillimin e procedurës përgatitore dhe bashkëpunimi me subjektet tjerë dhe palët e dhura, deri në përfundimin e hetimeve dhe vendosjes për ngritjen e propozimit përkatës për veprim të mëtejshëm³⁴⁶,

³³⁹ Neni 16-18 KDM.

³⁴⁰ Neni 19-29 KDM.

³⁴¹ Neni 30-31 KDM.

³⁴² Neni 32- 38 KDM.

³⁴³ Neni 38- 39 KDM.

³⁴⁴ Neni 40-50 KDM.

³⁴⁵ Neni 51-54 KDM.

³⁴⁶ Neni 55-63 KDM.

- kreu i dymbëdhjetë – arresti i përkohshëm, ndalimi policor dhe paraburgimi, duke vu në spikamë punën sa më efektive të prokurorëve dhe gjykatësve nga se afate për veprim janë të natyrës urgjente. Procedura e veprimit është më specifike dhe bartësit e përgjegjësive duhet ta respektojnë në mënyrë më të mirë të mundshme³⁴⁷,

- kreu i trembëdhjetë – parashih shqyrtimin gjyqësor dhe veprimin e palëve dhe subjekteve duke e karakterizuar rolin e gjykatësit individual, ose si kryetar i trupit gjykues për të mitur³⁴⁸,

- kreu i katërbëdhjetë – parashihet puna me mjetet juridike dhe aktivitetet e subjekteve në procedurë si dhe të palëve të tjera të interesuara,³⁴⁹

ç) Pjesa e katërt

Ndërmjetësimi dhe ekzekutimi i masave dhe i dënimeve

- kreu i pesëmbëdhjetë – procedura e ndërmjetësimit si risi në KPDM duke u bazuar në Ligjin për Ndërmjetësimin. Gjyqtari dhe prokurori duhet ti njoftojnë palët për veprime dhe qëllimin e procedurës së ndërmjetësimit, kohëzgjatjen dhe efektin si dhe modalitetet tjera³⁵⁰

- kreu i gjashtëmbëdhjetë – ekzekutimi i masave të diversitetit, si dhe procedura dhe fillimi i bashkëpunimit me shërbimin sprovues për fillimin e ekzekutimit³⁵¹

- kreu i shtatëmbëdhjetë – ekzekutimi i masave edukative, procedura e fillimit të ekzekutimit të masave edukative si dhe pjesëmarrja dhe roli i subjekteve dhe palëve në procedurë të mëtejme,³⁵²

- kreu i tetëmbëdhjetë – ekzekutimi i dënimeve, ndaj të miturve mund të shqiptohen llojet e dënimeve të parapara sipas dispozitave ligjore, andaj procedura e ekzekutimit ka specifika të veta që subjekte, palët institucionet duhet t'i përfillin³⁵³

³⁴⁷ Neni 64-68 KDM.

³⁴⁸ Neni 69-76KDM.

³⁴⁹ Neni 77-80 KDM.

³⁵⁰ Neni 81-82 KDM.

³⁵¹ Neni 83 KDM.

³⁵² Neni 84-130 KDM.

³⁵³ Neni 131-140 KDM.

- kreu i nëntëmbëdhjetë- ndihme pas ekzekutimit të masave për edukimin institucional ose burgimit të të miturit, parasheh komunikimin, bashkëpunimin si dhe ndihmën institucionale gjatë fillimit të ekzekutimit të masës ose dënimi për të mitur nga ana e organeve përkatëse³⁵⁴.

- kreu i njëzetë – ekzekutimi i masave të trajtimit të detyrueshëm rehabilitues ose trajtimi i detyrueshëm psikiatrik, duke iu referuar dispozitave nga Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe zbatimin e tyre përshtatshëm³⁵⁵.

d) Pjesa e pestë

Procedura gjyqësore që përfshinë veprat penale të kryera ndaj fëmijëve

- kreu i njëzet e një – gjykimi i madhorëve për vepra penal të kryera ndaj fëmijëve, lloj procedure që zhvillohet duke pasur parasysh dispozitat ligjore që zbatohen për të mitur sikurse kryerës të veprave penale³⁵⁶.

e) Pjesa e gjashtë

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

- kreu i njëzet e dy – paraqet mënyrën dhe qartësimin e dispozitave të KPDM që u referohen kryerësve të veprave penale nga ana e të miturve³⁵⁷.

6. Karakteristikat kryesore të procedurës përgatitore për të mitur

Fillimi i procedurës përgatitore ndaj të miturit ndërlidhet me parimet procedurale sikurse janë parimi i publicitetit, parimi i ndarjes së zhvillimit të procedurës përgatitore, parimi i gjykimit te drejte, parimi i ekonomizimit, etj., qe drejtpërdrejt ndikojnë ne

³⁵⁴ Neni 141-143 KDM.

³⁵⁵ Neni 144 KDM.

³⁵⁶ Neni 145-153 KDM.

³⁵⁷ Neni 154-156 KDM.

efikasitetin e procedurës. Bartësit e përgjegjësive duhet të kenë njohuri të duhura për zbatimin e dispozitave ligjore, nga se gjatë punës vazhdimisht duhet mbrojtur dinjitetin e të miturit. Të gjitha këto parime e përcjellin procedurën përgatitore me qëllim që dinjiteti i të miturit të ruhet dhe mos të shkaktohet shqetësim të i njëjti. Sipas KDM të Kosovës, procedura përgatitore fillon me aktvendimin për fillimin e procedurës përgatitore. Aktvendimi nxjerrët pasi që vërtetohet, se i mituri në kohën e kryerjes së veprës penale ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeçare, e cila vërtetohet në bazë të certifikatës së lindjes ose ndonjë dokumenti tjetër personal.

Para se të nxirret aktvendimi për fillimin e procedurës përgatitore, prokurori i shtetit duhet të shikon shkresat e lëndës, e me theks të posaçëm të përcjellë qëndrimin e të miturit në polici.

Afati kohor i privimit prej lirie nuk guxon të jetë më i gjatë se 24 orë, dhe i mituri gjatë kohës së qëndrimit në paraburgim, duhet të ndahet nga të paraburgosurit madhor me qëllim që mos të ndikohet nga ta.

Qëndrimi i të miturit në ndalim policor, llogaritet prej kohës së privimit prej lirie, duke u shënuar saktë data, koha, që nënkupton orën dhe minutat, të cilët do të llogariten në veprimet e mëtejme. Gjatë marrjes në pyetje të miturit duhet plotësuar këto kushte:

- që të jetë prezent përfaqësuesi i tij ligjor – prindi;
- po qe se nuk ka prind, të jetë prezentë prindi adoptues, ose kujdestari i caktuar për të miturin;
- varësisht prej fazës së zhvillimit të procedurës përgatitore, prokurori publik duhet të jetë i kujdesshëm që të miturit t'i caktojë mbrojtës;
- që t'i respektojë të gjitha të drejtat e garantuara sipas dispozitave të KPPK-së.

Kryesit e mitur të veprës penale, mund t'i caktohet paraburgimi në afat prej 30 ditëve, prej momentit të arrestimit, ndërsa paraburgimi mund t'i zgjatet nga kolegji për të mitur i gjykatës kompetente edhe për 2 (dy) muaj.

I mituri nuk duhet të merret në pyetje më shumë se dy herë, që nënkupton se të njëjtit duhet ti ruhet dinjiteti, mos ti shkaktohen shqetësime apo trazime shpirtërore. Gjatë marrjes në pyetje, mos t'i parashtrohen pyetje provokative, të dëgjohet në prezencën e përfaqësuesit të tij ligjor – prindit, e po që se kjo nuk mund të përmbushet për arsyet e ndryshme, t'i caktohet kujdestari nga ana e qendrës për punë sociale, etj.

T'i mundësohet liria e komunikimit me mbrojtësin, i cili i caktohet sipas detyrës zyrtare po që se nuk ka, të gjitha procedurat të cilat zhvillohen ndaj të miturit të jenë konfidenciale, si dhe incizimet e bëra gjatë i procedurës, mos të bëhen publike pa autorizimin e gjykatës.

Sipas KDM, për veprat penale të kryera nga i mituri që në kohën e kryerjes ende nuk i ka 16 (gjashtëmbëdhjetë) vite dhe për ato vepra penale parashihet dënimi me burgim deri në tre vjet ose dënimi me gjobë, mund të shqiptohet masa e diversitetit.

Nëse është filluar procedura përgatitore dhe janë grumbulluar provat e duhura, prokurori publik vlerëson provat dhe vendos për të ngritur propozimin përkatës.

Propozimin për shqiptimin e masës edukative, prokurori e paraqet ndaj të miturit, i cili në kohën e kryerjes së veprës penale nuk ka mbushur moshën mbi 16 vite. Qëllim i paraqitjes së propozimit për masën edukative, e ka mbështetjen në dispozitat ligjore përkatëse. Masat edukative janë disallojësh, andaj duhet zgjedhur masën adekuate, për të arritur qëllimin e duhur dhe të kontribuohet në rehabilitimin dhe zhvillimin e kryerësit të mitur.

Prokurori paraqet propozimin për shqiptimin e dënimit, ndaj kryerësit të mitur të veprës penale, i cili në kohën e kryerjes së veprës penale ka mbushur moshën mbi 16 vjeçare³⁵⁸.

Propozimi i paraqitur duhet të arsyetohet me provat të cilat grumbullohen dhe vlerësohen, ashtu që prezantimi i çështjes penale të jetë në përputhshmëri me ligjin. Gjyqtari për të mitur mund të

³⁵⁸ Neni 33 dhe 34 par 1 dhe 2 KDM.

vendos që propozimin e paraqitur në gjykatë ta hedhë dhe pushojë procedurën për arsyet e parapara ligjore.

Trupi gjykues, duhet të jetë i përbërë prej gjykatësit për të mitur, si dhe gjyqtarëve porotë për të mitur. Gjatë zhvillimi të procedurës përgatitore ekziston mundësia e ankimimit të vendimeve të nxjerra që e obligon gjykatën të veprojë.

Varësisht prej rrjedhës së procedurës përgatitore, prokurori mund të pezullojë ndjekjen penale ndaj kryesit të mitur dhe pas vlerësimit të nxjerr aktvendimin për shqiptimin e masës së diversitetit.

Dispozitat e KPPK-së zbatohen përshtatshmërisht, deri në përfundim të procedurës. Gjatë mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, duhet të jenë prezentë të gjitha palët të parapara me dispozita ligjore, i mituri (asnjëherë nuk mund të mbahet gjykim pa prezencën e të miturit), përfaqësuesi ligjor, ose kujdestari i caktuar, mbrojtësi, si dhe prokurori, i cili e përfaqëson rastin penal.

Bashkimi i procedurës përgatitore me atë me të rritur mund të bëhet në kuptim të dispozitave ligjore³⁵⁹, për sqarimin e çështjeve të përgjithshme dhe të spektrit të gjerë, por procedurën e udhëheqë trupi gjykues për të mitur. Trupi gjykues duhet të jetë në përbërje të paraparë sipas ligjit, që përpos gjykatësit për të mitur, gjyqtarët laik (porotë) është e preferuar që të jenë nga rangu i pedagogëve, sociologëve, duke llogaritur se jenë më adekuatë për punë.

Të miturit i shqiptohen masa edukative, por edhe dënimi në kuptim të dispozitave pozitive ligjore, e kjo nënkupton që ka të drejtë pas marrjes së aktvendimit ose aktgjykimit, i mituri të shfrytëzojë të drejtën e ankesës. Ankesa është mjet juridik i rregullt, ndërsa mjete të jashtëzakonshme juridike janë, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë³⁶⁰, si dhe kërkesa për rishikim të Procedurës Penale³⁶¹.

³⁵⁹ Neni 47 par 2 KDM.

³⁶⁰ Neni 451 i KPPK.

³⁶¹ Neni 438 i KPPK.

7. Roli i prokurorit të shtetit në procedurën për të mitur

Prokurori i shtetit e fillon procedurën përgatitore ndaj të miturit, pasi ta pranon kallëzimin penal nga policia, personat e tjerë, ose nga burimet tjera ekzistuese. Procedura përgatitore zhvillohet me kujdes të posaçëm, duke pasur parasysh personalitetin e të miturit, zhvillimin shpirtëror, psikologjik, në mbështetje të dispozitave të KRK, KDM, KPPK-së, si dhe instrumenteve dhe akteve të tjera ndërkombëtare³⁶².

Pasi që të paraqitet kallëzimi penal, kur prokurori vlerëson se ka bazë për shqiptimin e masës së diversitetit, atëherë përcaktohet për llojin e masës përkatëse. Prokurori në procedurën përgatitore për të mitur, nxjerrë aktvendimin për fillimin e procedurës përgatitore, kopjen e të cilit ia dërgon gjykatësit për të mitur për procedurë të mëtejme. Prej nxjerrjes së aktvendimit për fillimin e procedurës përgatitore fillon me grumbullimin e provave të nevojshme. Gjatë të gjitha zhvillimeve procedurale kontakti dhe bashkëpunimi me gjykatësin për të mitur mbahet për ta përmbledhur çështjen penale.

8. Procedura përgatitore për të mitur

Procedura përgatitore për të mitur fillon me aktvendimin e prokurorit të shtetit për fillimin e procedurës përgatitore³⁶³ kur ekziston dyshimi i bazuar se i mituri ka kryer veprën penale. Njoftohet Qendra për Punë Sociale neni 56 par 3 KDM, Shërbimi sprovues në kuptim të nenit 8 par. 2 të KDM-së, për përpilimin e anketës

³⁶² Ndër të tjera, rregullat Standarde Minimale të Kombeve Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të Mitur (Rregullat e Pekinit), të miratuara nga rezoluta e Asamblesë së përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, 40/33 të datës 29 nëntor 1985, Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Delikuencës së të miturve (Udhëzimet e RIADIT), të miratuara dhe të shpallura me Rezolutën 45/112 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara me 14 dhjetor 1990, sesioni 68, plenar, Rregullat Standarde Minimale për Masat jo Ndëshkimore (Rregullat e Tokios) të miratuara me Rezolutën 45/110 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, të datës 14 dhjetor 1990.

³⁶³ Rasti penal PP nr. 282/08, aktvendimi për fillimin e procedurës përgatitore, ndaj të paraqiturit të mitur F.K. nga Prizreni, për shkak të veprës penale të dhunimit si bashkëkryerës nga neni 193 par 2 nën par1 lidhur me nenin 23 të KPK-ës.

sociale. Gjatë zhvillimit të procedurës përgatitore, i mituri gëzon të drejta të garantuara me KRK, KDM, KPPK, si dhe aktet dhe marrëveshjet e tjera ndërkombëtare.

Të drejtat e garantuara, siç është e drejta për tu njoftuar për veprën penale për të cilën dyshohet se e ka kryer, të drejtën për të mos u deklaruar për veprën penale për të cilën dyshohet se e ka kryer, përpos shënimeve që e vërtetojnë identitetin, të drejtën për të pasur mbrojtës në çdo fazë të procedurës, etj.³⁶⁴. Si e drejtë ndër më të rëndësishmet është e drejta për të pasur mbrojtës (avokat)³⁶⁵ si dhe e drejta për tu njoftohet për rrjedhat gjatë grumbullimit të provave në të gjitha fazat e procedurës. Përveç prokurorit gjatë procedurës përgatitore mund të paraqesin propozime për prova të reja gjykatësi për të mitur, avokati si dhe palët e tjera të interesuara.

Prokurori e drejton rrjedhën e zhvillimit të procedurës përgatitore, vlerëson provat e grumbulluara dhe pas përfundimit të procedurës përgatitore, fillimisht e njofton gjykatësin për të mitur për përfundimin me grumbullimin e provave, me qëllim të pritjes së ndonjë propozimi për ndonjë provë shtesë. Pas përfundimit të kësaj faze procedurale vlerësimit të provave, vendos për paraqitjen e propozimit për shqiptimin e masës edukative ose dënimit.

Sipas LPP-së, prokurorit ka bërë kërkesë për zhvillimin e procedurës përgatitore, ndërsa aktvendimin për fillimin e procedurës përgatitore e ka nxjerrë gjyqtari për të mitur³⁶⁶. Pas përfundimit të procedurës përgatitore gjykatësi për të mitur shkresat e lëndës ia ka dërguar prokurorit për vlerësim dhe vendosje të mëtejme.

Gjithashtu ndaj të miturve mund të shqiptohen edhe dënimet sikurse janë, dënimi me gjobë, urdhri për punë në dobi të përgjithshme dhe burgimi për të mitur.

Përndryshe, prokurori është prezentë gjatë procedurës përgatitore deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor. Aktiviteti i prokurorit vjen në shprehje me paraqitjen e mjeteve të rregullta juridike -

³⁶⁴ Neni 231 KPPK.

³⁶⁵ Neni 43 KDM.

³⁶⁶ Neni 470 i LPP-së.

ankesës, si dhe mjeteve të jashtëzakonshme sikurse janë kërkesa për rishikimin e procedurës penale³⁶⁷ dhe kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë³⁶⁸.

9. Masat e diversitetit

Në frymën e udhëzimeve dhe rregullave të përmendura, u parapanë masat e diversitetit, si hap më i avancuar që ishin të parapara edhe me LPMK. Llojet e masave të diversitetit, të parapara sipas KDM³⁶⁹, janë më favorizues për pozitën e të miturit nga se kanë për qëllim që ndaj kryerësit të mitur mos të fillojë procedura përgatitore si dhe të miturit ti mundësohet integrimi sa më të shpejtë në shoqërori. Mund ti shqiptohen të miturit, krahas masave edukative dhe dënimeve të tjera³⁷⁰. Shqiptimi i masave të diversitetit ka për qëllim që të parandalojë fillimin e procedurës përgatitore ndaj kryesit të mitur, për veprën penale të kryer.

Sa i përket kriminalitetit të miturve në Kosovë, zakonisht paraqiten vepra penale të llojeve të ndryshme sikurse janë: rrezikimi i trafikut publik, lajmërimi i rrem, lëndimi i lehtë trupor, vjedhja, falsifikimi i dokumenteve e tjerë. Për veprat penale nga kryerësit e mitur, që parashihet dënimi me gjobë, ose dënimi me burgim deri në 3 vite, paraqet kriterin për prokurorin ose gjyqtarin për shqiptimin e masës përkatëse të diversitetit.

Për shqiptim të masave të diversitetit duhet të jenë të plotësuara disa kushte ligjore:

- pranimi i përgjegjësisë për veprën penale të kryer nga i mituri,
- që për veprën penale e cila është kryer është i paraparë dënimi me gjobë ose dënimi me burgim deri në 3 vite,
- gatishmëria e shprehur e të miturit që të pajtohet me palën e dëmtuar,

³⁶⁷ Neni 438 i KPPK-së.

³⁶⁸ Neni 451 i KPPK-së.

³⁶⁹ Neni 18 KDM.

³⁷⁰ Neni 7 par. 1 KDM.

- fillimisht, shqiptimin e masës e bënë prokurori publik kompetentë,

- ekzekutimin e masës e përcjellë shërbimi sprovues (shërbim i ri institucional i në Kosovë, nga viti 2003, vepron në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë).

Puna e shërbimit sprovues sqarohet në Ligjin mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale. Në ligj parashihen detyrat dhe përgjegjësitë e shërbimit sprovues, duke filluar prej përgatitjes së anketës sociale për kryesit e mitur, mbikëqyrjen dhe ofrimin e ndihmës për personat e dënuar të cilët vuajnë dënimet alternative, ofrimin e ndihmës për kryesitë e veprave penale të cilët janë të varur nga droga ose alkooli, që iu janë nënshtruar trajtimit të detyruar rehabilitues në liri, mbikëqyrjen dhe ofrimin e ndihmës për personat e dënuar, të dënuarve të liruar me kusht si dhe ndërmarrjen e veprimit procedural përkatës.

Në kreun e katërt (IV) të KDM, janë a paraparë masat e diversitetit, të cilat u shqiptohen kryesve të mitur të veprave penale për të cilat është paraparë dënimi me gjobë apo me burgim deri në tre vjet.

Përndryshe, masat e diversitetit janë disa llojesh³⁷¹, dhe varësisht prej vlerësimit që i bëhet kallëzimit penal, prokurori ose gjykatësi për të mitur, përcaktohet për llojin e masës që do ti shqipton kryesit të mitur.

Këto masa janë:

a) pajtimi në mes të kryesit të mitur dhe palës së dëmtuar, duke përfshirë edhe kërkim faljen nga i mituri ndaj palës së dëmtuar;

b) pajtimi ndërmjet të miturit dhe familjes së tij;

c) kompensimi i dëmit palës së dëmtuar në bazë të marrëveshjes së ndërsjellë ndërmjet të dëmtuarit, të miturit dhe përfaqësuesit të tij ligjor, në përputhje me situatën financiar të të miturit;

ç) vijimi i rregullt në shkollë;

d) pranimi i punësimit apo aftësimi në një profesion adekuatë në aftësitë dhe shkathtësitë e tij;

³⁷¹ Neni 18 KDM.

e) kryerja e punës pa pagesë në dobi të përgjithshme në pajtim me aftësinë e kryesit të mitur për kryerjen e punës së tillë. Kjo masë mund të shqiptohet me pëlqimin e të miturit në kohëzgjatje prej 10(dhjetë) deri në 60(gjashtëdhjetë) orë,

ë) edukimi në rregullat e trafikut, dhe

f) këshillimi psikologjik.

Për shqiptimin e masës së diversitetit, duhet vërtetuar moshën e kryerësit të mitur, kohën e kryerjes së veprës penale, fazën e zhvillimit psikofizik të miturit, dëmin që iu është shkaktuar të dëmtuarit, rrethanat të cilat kanë ndikuar te i mituri për ndërmarrjen e veprimit të kundërligjshëm, për të arritur efektin e dëshiruar.

Subjektet në procedurë, duhet të kenë kujdes gjatë punës, që mos ta lëndojnë personalitetin e të miturit. Rezultatet e arritura për shqiptimin e masave të diversitetit, ndaj kryesve të mitur të veprave penale, deri më tani vlerësohen se janë të mira, por duhet punuar me përkushtim edhe më të madh për ngritjen e kapaciteteve të duhura.

10. Masat edukative

Për kryerësit e mitur të veprave penale, varësisht prej rrjedhës së procedurës rreth grumbullimit të provave dhe vlerësimit të tyre, mund të paraqitet propozimi për shqiptimin e masës edukative. Përndryshe KDM parasheh disa lloje të masave edukative që u shqiptohen kryerësve të mitur³⁷², sikurse janë:

a) masat disiplinore,

b) masat e mbikëqyrjes së shtuar dhe

c) masat institucionale

Qëllimi i shqiptimit të masës edukative konsiston në atë që të kontribuohet te i mituri në rehabilitimin dhe zhvillimin adekuat te kryesi i mituri veprës penale. Qëllim i masës është që të arrihet efekti i dëshirueshëm edukativ, të arrihet efekti i dëshirueshëm në aftësimin profesional, dhe të ndikohet pozitivisht në të miturin që mos të përsëris sjelljet recidiviste.

KDM njeh tri lloje të masave edukative:

³⁷² Neni 20 KDM.

1. në grupin e parë, masat disiplinore:
 a) qortimi gjyqësor dhe
 b) dërgimi i të miturit në qendrën disiplinore, të cilat u shqiptohen kryerësve të mitur në rastet kur vepra penale është kryer nga pakujdesia dhe pa dashje.

2. në grupin e dytë, masat edukative të mbikëqyrjes së shtuar:
 a) mbikëqyrja e shtuar nga ana e prindit, prindit adoptues ose kujdestarit,
 b) mbikëqyrja e shtuar nga familja tjetër, dhe
 c) mbikëqyrja e shtuar nga ana e organit të kujdestarisë të cilat lloje u shqiptohen kryerësve të mitur me qëllim të ndihmohet kthimi dhe integrimi në rrethin familjar dhe shoqëror.

3. Në grupin e tretë të masave edukative, masat institucionale të cilat janë:

a) dërgimi i të miturit në institucionin edukues,
 b) dërgimi i të miturit në institucionin edukativo korrektues dhe
 ç) dërgimi i të miturit në institucionin për kujdes të posaçëm, që për shqiptimin e saj kërkohet procedurë përkatëse.

Qëllimi i shqiptimit të masave edukative, është që te kryesit të mitur ti caktohet një mbikëqyrje e plotë dhe profesionale për integrim dhe aftësim më të shpejtë në shoqëri. Përndryshe, masat edukative shqiptohen nga ane e gjykatës kompetente, dhe pas marrjes së vendimit atëherë kyçen edhe subjektet tjera të parapara me dispozita ligjore.

11. Burgimi për të mitur

KDM në pjesën e dytë kreu i dytë parasheh masat dhe dënimet e zbatueshme, që mund t'u shqiptohen kryesve të mitur të veprave penale: gjobën, urdhri për punë në dobi të përgjithshme si dhe burgimin për të mitur³⁷³. Për të shqiptuar dënimin me burgim, subjektet në procedurë duhen të kenë kujdes se ky lloj dënimi shqiptohet ndaj kryerësve të mitur të cilët në kohën e kryerjes së veprës penale kanë

³⁷³ Neni 7 KDM.

mbushur moshën 16 (gjashtëmbëdhjetë) vjeçare dhe ka kryer veprën penale e cila është e dënueshme me dënim burgu mbi pesë vite.

Këto janë karakteristikat themelore sipër prokurorin i cili i zhvillon hetimet në procedurën përgatitore, që me vlerësimin e provave të nxjerra, në kuptim të dispozitave ligjore përcaktohet për propozimin përkatës.

Pas paraqitjes së propozimit përkatës, procedura penale për të mitur zhvillohet në gjykatën kompetente si dhe dënimi i shqiptuar duhet të caktohet nga ana e të njëjtës gjykatë. Gjykatësi duhet ta ketë parasysh se burgimi për të mitur nuk mund të shqiptohet në kohëzgjatje më pak se 6 (gjashtë) muaj, as më shumë se 5 (pesë) vite, në muaj dhe vite të plota³⁷⁴, duke respektuar dispozitat ligjore.

Gjatë punës ndeshemi me kryerës të mitur të veprave penale, atëherë duhet pasur kujdes gjatë punës. Kujdesi bie në organet që janë të parapara për punë me të mitur, siç janë, policia, prokuroria, gjykata, shërbimi sprovues, etj. I mituri i ndaluar në polici duhet të ketë tretman të mirë, mos ti nënshtrohet maltretim ose trysnisë për të pranuar veprën penale për të cilën dyshohet se e ka kryer. Respektimi i të drejtave të garantuara me kornizën ligjore vendore dhe ndërkombëtare vjen në shprehje gjatë kohës së ndalimit policor ashtu edhe kur të dërgohet para prokurorit ose gjykatësit kompetent. Të miturit i garantohen të drejta nga KDM si dhe nga KPPK, të bazuara edhe në frymën e Kushtetutës dhe akteve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare.

Të drejtat që i takojnë të miturit sipas dispozitave ligjore janë:

- i mituri i ndaluar në polici nuk duhet të qëndroj në vend të njëjtë me kryerësit madhor të veprave penale,
- gjatë kohës së qëndrimit se a mund ta e përballoj qëndrimin në aspektin psiko-fizik duhet të dërgohet në qendrën spitalore-

³⁷⁴ Në rastet, kur i mituri është kryerës i veprës penale të rëndë (vepra penale e vrasjes së rëndë nga neni 147 KPK, vepra penale krimi i organizuar neni 274 KPK, ose për vepra penale në bashkim që për secilën parashihet dënim me burg prej më shumë se dhjetë vjet).

emergjencë, për shikim dhe marrje të pëlqimit për procedim të mëtejshëm (kjo ndërmerret brenda afatit prej 24 orëve).

- duhet të njoftohet prokurori publik menjëherë prej momentit të ndalimit për veprim të mëtejshëm,

- nuk guxon të qëndroj në ndalim më shumë se 24 (njëzet e katër) orë,

- të njëjtit i caktohet paraburgimi në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) ditë,

- paraburgimi mund të zgjate (vazhdohet) edhe për 60 (gjashtëdhjetë) ditë,

- i nënshtrohet procedurës së ekzekutimit dhe parashkrimit,

- mund ti nënshtrohet procedurës së lirimit me kusht.

Gjatë zhvillimit të procedurës penale për të mitur, përshtatshëmrisht zbatohen dispozitat e KPPK-së, sikurse për kryerësit e rritur të veprave penale.

12. Ekzekutimi i masave dhe i dënimeve

Me shqiptimin e masës së diversitetit, subjekti që e ka shqiptuar masën, prokurori ose gjykatësi për të mitur, janë të obliguar që aktvendimin si dhe shkresat e tjera të duhura t'ia dërgon shërbimit sprovues kompetent për përcjellje dhe ekzekutim. Shërbimi sprovues për rrjedhën e procedurës gjatë ekzekutimit e njofton organin përkatës, nga i cili raporton për suksesin dhe vështirësitë aktuale.

Pasi marrjes së aktvendimit nga shërbimit sprovues, i njëjti mbanë relacione të afërta me organin i cili e ka shqiptuar masën përkatëse duke raportuar në afatet kohore të parapara.

Me përmbushjen e obligimeve të parapara nga aktvendimi për shqiptimin e masës së diversitetit, shërbimi sprovues fillon punën për ekzekutimin e masës. Fillimisht e ven kontaktin me familjen dhe të miturin i cili gjendet nën masë dhe respekton afatet për raportim për mbarëvajtjen e saj. Shënimet që konstatohen korrespondojnë me punën e ekipit të shërbimit sprovues në terren, ndërsa raportet paraqiten çdo tre muaj. Me përmbushjen e obligimeve nga aktvendimi dhe nëse çdo gjë është në rregull, atëherë vendoset për ndërprerjen

e procedurës së mëtejme, në të kundërtën vazhdohet me procedurë. Për veprimet e ndërmarra njoftohet prokuroria dhe gjykata³⁷⁵.

Ekzekutimi i masave edukative të shqiptuara nga ana e gjykatës kompetente, është obligim i shërbimit sprovues që ndodhet në territorin ku i mituri e ka vendbanim e përhershëm ose të përkohshëm³⁷⁶.

Është detyrë e shërbimit sprovues që pas marrjes së vendimit gjyqësor nga ana e gjykatës kompetente, menjëherë të vendos kontaktin me shërbimin sprovues, për tu pajisur me dokumentacionin përkatës. Të gjitha veprimet procedurale që kërkohen për tu ndërmarrë, sikurse janë urdhrat për ekzekutimin e masës i lëshon gjykata kompetente. Prej momentit kur shërbimi sprovues e merr dokumentacionin e duhur, formon ekipin përkatës dhe fillon përcjelljen e ekzekutimit të masës. Fillimi i punës nënkupton njohjen me personin, respektimin e personalitetit dhe dinjitetit të tij si dhe ndihmën eventuale gjatë punës. Hartimi i programit nga ana e shërbimit sprovues ka karakter të fuqishëm nga se me një program të mirë ndikohet më shpejtë dhe më mirë në ekzekutim. Puna e cila kryhet duhet të jetë në relacione të ngushtë edhe me gjykatën kompetente e cila e ka shqiptuar, për të arritur efektin e dëshiruar.

Shpenzimet e shkaktuara gjatë zbatimit të masave të diversiteti dhe atyre edukative bijën në barrë të mjeteve buxhetore të shtetit.

Sa i përket ekzekutimit të dënimit me gjobë, përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale sikurse ndaj të rriturve, por duhet pasur parasysh që gjoba e shqiptuar ndaj kryesit të mitur të veprës penale nuk mund të zëvendësohet me dënim me burgim³⁷⁷. Dispozitat e Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale, zbatohen edhe te ekzekutimi i urdhrit për punë në dobi të përgjithshme me dallim që shërbimi sprovues është i

³⁷⁵ Neni 83 i KDM.

³⁷⁶ Neni 84 i KDM.

³⁷⁷ Neni 131 KDM.

obliguar ta njoftoj gjykatën, përkatësisht gjykatësin që e ka shqiptuar masën, nga se e njëjta është ma afat kohëzgjatje të caktuar³⁷⁸.

Ekzekutimi i dënimit me burgim për të mitur fillon me procedurë të njëjtë sipas Ligjit përkatës, po me rëndësi është që i mituri të dërgohet në institucionin korrektues, e jo të vuajë dënimi së bashku me të rritur³⁷⁹. Dispozita e Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale përshtatshmërisht zbatohen ndaj të miturve por me specifika. Përndryshe KDM³⁸⁰, ka specifikuar edhe çështjen e vendosjes së të miturve duke paraparë ndarjen e femrave nga meshkujt, si dhe modalitetet tjera.

Të miturit i cili dërgohet në ekzekutim të dënimit me burgim, duhet ti sigurohet pranim më i kapshëm, sigurimi i kushteve në nivel më të mirë së bashku me kushtet përcjellëse, siç janë mundësimi i arsimimit, zhvillimi i aktiviteteve fizike, angazhimi në ushtrime kohë dhe jetë të lirë të programuar, etj.

Dispozitat ligjore pozitive vendore dhe ato ndërkombëtare, garantojnë të drejtat dhe liritë themelore, andaj, është obligim ligjor i të gjitha subjekteve që t'i respektojnë dhe t'u përmbahen me përpikëri.

Përfundimi – konkluzioni

Procedura penale për të mitur ka shumë specifika, njëra ndër to janë efikasiteti i procedurës penale për të mitur si dhe mbrojtja e dinjitetit të të miturit. Procedura përgatitore fillon me nxjerrjen e aktvendimit për fillimin e procedurës përgatitore. Pasi që të nxirret aktvendimi për fillimin e procedurës përgatitore fillohet me mbledhjen e provave si të atyre personale ashtu edhe të atyre materiale.

Mbledhja e informatave të nevojshme që e karakterizojnë personalitetin e të miturit, që gjatë zhvillimit të procedurës mund të vendoset për shqiptimin e masës përkatëse. Ato masa janë masat e

³⁷⁸ Neni 132-133KDM.

³⁷⁹ Neni 134 KDM.

³⁸⁰ Neni 136 KDM.

diversitetit, nëse veprohet me të njëjtat, kurse pas përfundimit të procedurës përgatitore paraqitet nevoja që të paraqitet propozimi për shqiptimin e masës edukative apo propozimit për shqiptimin e dënimit.

Në këtë drejtim shikuar procedura kalon në fazën e procedurës përgatitore, procedurës për vendosjen për të paraqitur propozimin përkatës, për të prezantuar subjektet dhe palët në shqyrtim gjyqësor si dhe procedurën përkitazi me mjetet juridike.

Përndryshe, respektimi i të drejtave të njeriut është çështje kryesore, sepse të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të garantuara me kushtetutë dhe ligje, pa u lënë anash aktet dhe instrumente të tjera ndërkombëtare.

Kjo i shtytë subjektet dhe palët në procedurë, që të respektojnë të drejtat e të miturit, duke filluar prej:

- të drejtës për jetë,
- të drejtën në identitet,
- të drejtën dhe lirinë e shprehjes në çdo lloj procedure,
- të drejtën në mbrojtje dhe mbrojtës,
- të mos keqpërdoret dhe abuzohet gjatë zhvillimeve procedurale ,
- të respektohet interesi dhe dinjiteti i fëmijës, për të cilin duhet të ketë përkujdesje të shtuar,
- të ketë të drejtën e pushimit dhe shfrytëzimin e kohës së lirë,
- të ketë të drejtën që të luftojë çdo formë të eksploatimit apo diskriminimit,
- të ketë të drejtën që mos të privohet prej lirie në mënyrë të kundërligjshme dhe të gëzojë mbrojtjen ligjore,
- që gjatë procedurës, të shqiptohen masa të diversitetit më shumë nga ana e prokurorëve dhe e gjykatave, me qëllim të ngritjes së efikasitetit, duke pasur parasysh qëllimin e shqiptimit të këtyre masave,
- dënimet alternative të parapara sipas LPMK, të jenë në rritje e sipër gjatë punës

- anketat sociale të jenë më gjithëpërfshirëse, duke mos përmbajtur propozimin për shqiptimin e masës eventuale,

- vendosja e të miturit në paraburgim të jetë sa më e kufizuar,

- të konstituohet një shërbim përkatës në nivel shtetëror për përkujdesjen e fëmijëve, të cilët janë kryerës të veprave penale të moshës nën katërbëdhjetë (14) vjet – (duke pasur parasysh që hasim në kryerës të veprave penale të kësaj moshe, kurse me ligj nuk është rregulluar asgjë, sa i përket tretmanit që duhet t’u ofrohet kësaj kategorie),

- të përshtaten dispozitat ligjore, me qëllim që gjatë punës mos të haset në vështirësi në implementim,

- të miturit gjatë marrjes në pyetje si në cilësinë e të paraqiturit, të dëmtuarit apo dëshmitarit mos t’i shkaktohet ngarkesë psikike që do të ndikon në dhënien e deklaratës.

Me respektimin të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë, ligje vendore, akte dhe marrëveshje ndërkombëtare me siguri që efikasiteti do të jetë më i mirë dhe do të respektohen dinjiteti i të miturve.

LITERATURA

Libra dhe artikuj

1. Deklarata Universale për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut e KB dhjetor 1948,
2. Paktit Fakultativ për të Drejtat Civile dhe Politike, 1966
3. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, 1950
4. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 15 prill, në fuqi nga 15 qershor 2008
5. Deklarata mbi të Drejtat e fëmijës, 1959
6. Konventa mbi të Drejtat e fëmijës, 1989
7. Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut, 1950,
8. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 1998
9. Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, Rregullorja e UNMIK-ut 25/2003, korrik 2003

10. Kodi Penal i Kosovës, Rregullorja e UNMIK-ut 26/2003, korrik 2003
11. Konventa e të drejtave të fëmijës, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, 20 nëntor 1989 Ligji për Prokurorin i Kosovës, Gazeta Zyrtare e KSAK, 32/1976, 28 korrik 1976
12. Ligj për Gjykata e rregullta, Gazeta Zyrtare KSAK, 21/1978, 28 prill 1978, Sahiti, Ejup, Argumentimi në procedurën penale, Tetovë 1999; Prishtinë 2006,
13. Ligji Penal për të Mitur i Kosovës, 20 Prill 2004,
14. Ligji nr. 03/L-003 për ndryshimin dhe plotësimin e KPPK-së,
15. Pakti Fakultativ për të Drejtat Civile dhe Politike, qershor 1986,
16. Përmbledhja e parimeve për mbrojtjen e të gjitha personave në çdo formë e paraburgimit apo arrestimit, miratuar nga Rezoluta e Asamblesë së përgjithshme nr. 43/173, 09 dhjetor 1998
17. Rregullorja e UNMIK-ut 01/1999, 25 qershor 1999, Për autorizimet e administratës së përkohshme në Kosovë
18. Rregullorja e UNMIK-ut 05/1999, 04 shtator 1999, Për themelimin e Gjykatës Ad hoc të instancës së fundit dhe të zyrës Ad hoc të prokurorit publik
19. Rregullorja e UNMIK-ut 24/1999, 12 dhjetor 1999, Për ligjin në fuqi në Kosovës.
20. Rregullorja e UNMIK –ut 53/2005, 20 dhjetor 2005,
21. Sahiti, Ejup, E drejta e Procedurës Penale, Prishtinë, 2005,
22. Salihu, Ismet, E drejta Penale për të mitur, Prishtinë 2005,
23. Çollaku, Hashim, Roli i Prokurorit të Shtetit në procedurën penale sipas KPPK,
24. Deklarata e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, 10 dhjetor 1948